

VENDIM
Nr.675, datë 18.6.2009

**PËR HAPJEN E FILIALIT TË UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, KORÇË, NË
QYTETIN E POGRADECIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 11, 25, 26 e 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në qytetin e Pogradecit, të filialit të Fakultetit të Ekonomisë, në programin e studimit të ciklit të parë, për “Turizëm”.
 2. Ky program studimi të realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është tri vite akademike.
 3. Në përfundim të programit të studimit të ciklit të parë “Turizëm”, përfitohet “Diplomë e nivelit të parë” DNP në “Turizëm”.
 4. Ky filial do të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2009-2010.
 5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.
 6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli”, Korçë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha